

V E N D I M
Nr.218, datë 10.5.1993

**PËR PËRQINDJEN E KONTRIBUTIT QË DERDHI NË NËRMARRJET, INSTITUCIONET,
ORGANIZATAT DHE PERSONAT JURIDIKË E FIZIKË PRIVATË**

Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.438, datë 2.12.1991 "Për kalimin e paaftësisë së përkohshme në punë në ndërmarrje, institucione, organizata dhe subjekte private, pika 2 ndryshohet si vijon:

"Ndërmarrjet, institucionet, organizatat dhe personat juridikë e fizikë privatë, pavarësisht nga forma e organizimit të tyre, derdhi në dobi të sigurimeve shoqërore për pagesat e pensione, të lejes së barrë lindjes dhe ndihmave për lindje e shpenzime varrimi 25 për qind mbi fondin e pagave të punonjësve të tyre.

Të vetëpunësuarit, individë ose pjesëtarët në ortakëri, derdhi në dobi të sigurimeve shoqërore për pagesat e pensione, të lejes së barrë lindjes dhe ndihmave për lindje e shpenzime varrimi 25 për qind mbi pagat fikse. Këto paga do të përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Shpenzimet për paaftësi të përkohshme në punë planifikohen dhe përballohen nga fondet e vetë ndërmarrjeve, institucioneve, organizatave dhe personave juridikë e fizikë privatë. Ky rregull të zbatohet edhe për ushtarakët e shërbimit aktiv të përhershëm".

Ky vendim hyn në fuqi më 1 qershor 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi